Thinking of you
Electrolux

EOB3410
EEB4231

SQ FURRË	UDHËZIMET PËR PËRDORIM	2
RU ДУХОВОЙ ШКАФ	ИНСТРУКЦИЯ ПО ЭКСПЛУАТАЦИИ	26

PËRMBAJTJA

1. TË DHËNA PËR SIGURINË 3
2. UDHËZIME PËR SIGURINË 4
3. PËRSHKRIM I PRODUKTIT 6
4. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË 6
5. PËRDORIMI I PËRDITSHËM 7
6. FUNKSIONET E ORËS 8
7. FUNKSIONET SHTESË 9
8. UDHËZIME DHE KËSHILLA TË NEVOJSHME 10
9. KUJDESI DHE PASTRIMI 18
10. SI TË VEPROJMË NËSE... 22
11. TË DHËNA TEKNIKE 23
12. INSTALIMI 23

ME JU NË MENDJE

Faleminderit që bletë një produkt Electrolux. Ju keni zgjedhur një produkt i cili sjell me vete dekada të tëra me përvojë dhe risi nga profesionistë. Gjenial dhe elegant, ky produkt është projektuar duke ju pasur ju në mendje. Pra, sa herë që ta përdorni mund të ndjeheni të sigurt se çdo herë do të merrni prej tij rezultate të shkëlqyera.

Mirë se vini në Electrolux.

Vizitoni faqen tonë të internetit në adresën:

Merrni këshilla përdorimi, broshura, informacion për ndreqjen e problemeve si dhe për shërbimin:
www.electrolux.com

Regjistroni produktin tuaj për shërbim më të mirë:
www.electrolux.com/productregistration

Blini aksesorë, pjesë konsumi, pjesë këmbimi origjinale për pajisjen tuaj:
www.electrolux.com/shop

KUJDESI DHE SHËRBIMI PËR KLIENTËT

Rekomandojmë përdorimin e pjesëve origjinale të këmbimit.
Kur kontaktoni me Shërbimin, sigurohuni që të dispononi të dhënat e mëposhtme.
Informacioni mund të gjendet në pllakën e specifikimeve. Modeli, PNC, Numri i serisë.

Paralajmërim / Të dhëna për sigurinë dhe kujdesin.

Të dhëna të përgjithshme dhe këshilla

Të dhëna për ambientin

Rezervohet mundësia e ndryshimeve.

1. TË DHËNA PËR SIGURINË

Përpara instalimit dhe përdorimit të pajisjes, lexoni me kujdes udhëzimet e ofruara. Prodhuesi nuk është përgjegjës nëse shkaktohen lëndime dhe dëme nga instalimi dhe përdorimi i pasaktë. Gjithmonë mbajini udhëzimet bashkë me pajisjen, për t'iu referuar në të ardhmen.

1.1 Siguria e fëmijëve dhe personave me probleme

⚠ **PARALAJMËRIM**
Rrezik mbytjeje, lëndimi ose gjymtimi të përhershëm.

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e sipër dhe persona me aftësi të kufizuara fizike, ndjesore ose mendore ose që nuk kanë eksperiencë dhe njohuri, nëse ata mbikëqyren nga një i rritur ose nga një person që është përgjegjës për sigurinë e tyre.
- Mos lejoni fëmijët të luajnë me pajisjen.
- Mbajini të gjitha materialet e ambalazhimit larg fëmijëve.
- Mbajini fëmijët dhe kafshët shtëpiake larg pajisjes, gjatë kohës që ajo punon ose kur ftohet. Pjesët e prekshme janë të nxehta.
- Nëse pajisja ka një mekanizëm për sigurinë e fëmijëve, ju rekomandojmë që ta aktivizoni.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja nuk duhet të kryhet nga fëmijët pa mbikëqyrje.

1.2 Siguria e përgjithshme

- Kur përdoret, pajisja nxehet nga brenda. Mos i prekni elementet e nxehjes që gjenden në pajisje. Përdorni gjithmonë doreza furre për të hequr ose për të futur aksesorët ose enët në furrë.
- Mos përdorni pastrues me avull për të pastruar pajisjen.
- Përpara punimeve të mirëmbajtjes, shkëputni furnizimin me rrymë elektrike.

- Mos përdorni pastrues gërryes të fortë ose kruajtëse të mprehta metalike për të pastruar xhamin e derës, sepse këto mund të gërvishtin sipërfaqen, gjë e cila mund të rezultojë në krisjen e xhamit.
- Për të hequr mbështetëset e rafteve, nxirrni fillimisht jashtë pjesën e përparme të mbështetëses së raftit dhe pastaj pjesën e pasme nga paretet anësore. Montojini mbështetëset e rafteve në rendin e kundërt.

2. ⚠ UDHËZIME PËR SIGURINË

2.1 Instalimi

⚠ **PARALAJMËRIM**
Vetëm një person i kualifikuar duhet ta instalojë këtë pajisje.

- Hiqni të gjithë paketimin.
- Mos instaloni ose mos përdorni një pajisjen të dëmtuar.
- Zbatoni udhëzimet e instalimit të dhëna me pajisjen.
- Gjithmonë bëni kujdes kur e lëvizni pajisjen sepse është e rëndë. Përdorni gjithnjë doreza sigurie.
- Mos e tërhiqni pajisjen nga doreza.
- Ruani largësitë minimale nga pajisjet dhe njësitë e tjera.
- Sigurohuni që pajisja të jetë e instaluar nën dhe pranë strukturave të sigurta.
- Anët e pajisjes duhet të jenë pranë pajisjeve ose njësive me të njëjtën lartësi.

Lidhja elektrike

⚠ **PARALAJMËRIM**
Rrezik zjarri dhe goditjeje elektrike.

- Të gjitha lidhjet elektrike duhen kryer nga një elektricist i kualifikuar.
- Pajisja duhet tokëzuar.
- Sigurohuni që të dhënat elektrike në pllakën e specifikimeve të përkojnë me karakteristikat e rrjetit elektrik. Nëse nuk përkojnë, kontaktoni me një elektricist.
- Përdorni gjithmonë një prizë të tokëzuar të instaluar si duhet.
- Mos përdorni përshtatës me shumë spina dhe kabllo zgjatuese.
- Sigurohuni që të mos dëmtoni prizën dhe kabllon elektrike. Kontaktoni me qendrën e shërbimit ose një elektricist për ndërrimin e kabllos elektrike të dëmtuar.
- Mos i lini kabllot që të prekin derën e pajisjes, veçanërisht kur dera është e nxehtë.
- Mbrojtja nga goditja e pjesëve me korrent dhe të izoluara duhet të shtrëngohet në mënyrë të tillë që të mos hiqet pa vegla.
- Pajisjen futeni në prizë vetëm në fund të instalimit. Sigurohuni që spina të jetë e arritshme pas montimit të pajisjes.
- Nëse priza është e lirë, mos e futni spinën.
- Mos e shkëputni pajisjen nga rrjeti duke e tërhequr nga kablloja elektrike. Gjithmonë tërhiqeni kabllon duke e kapur nga spina.
- Përdorni mjetet e duhura izoluese: çelësa mbrojtës të linjës, siguresa (siguresa tip vidë të hequra nga mbajtësja), çelësa të humbjeve në tokëzim dhe kontaktorë.
- Instalimi elektrik duhet të ketë një pajisje instaluese e cila ju lejon të shkëpusni pajisjen nga rryma elektrike në të gjitha polet. Pajisja instaluese duhet të ketë një hapje kontakti me gjerësi minimale 3 mm.

2.2 Përdorimi

PARALAJMËRIM
Rrezik lëndimi, djegiesh ose goditjeje elektrike ose shpërthimi.

- Përdoreni pajisjen në mjedis shtëpiak.
- Mos i ndryshoni specifikimet e kësaj pajisjeje.
- Sigurohuni që vrimat e ajrimit nuk janë të bllokuara.
- Mos e lini pajisjen të pambikëqyrur gjatë punës.
- Çaktivizojeni pajisjen pas çdo përdorimi.
- Bëni kujdes kur hapni derën e pajisjes ndërkohë që pajisja është në punë. Mund të dal ajër i nxehtë.
- Mos e përdorni pajisjen me duar të lagura ose kur ajo ka kontakt me ujin.
- Mos ushtroni presion mbi derën e hapur.
- Mos e përdorni pajisjen si sipërfaqe pune ose për të ruajtur sende.
- Mbajeni gjithmonë të mbyllur derën e pajisjes kur pajisja është në punë.
- Hapeni me kujdes derën e pajisjes. Përdorimi i përbërësve me alkool mund të krijoj një përzierje alkooli dhe ajri.
- Mos lejoni që pajisja të bjer në kontakt me shkëndija apo flakë të hapura kur hapni derën.
- Mos vendosni produkte të ndezshme ose sende të lagura me produkte të ndezshme brenda, pranë ose mbi pajisje.

PARALAJMËRIM
Rrezik dëmtimi i pajisjes.

- Për të parandaluar dëmtime ose çngjyrime të smaltit:

  – Mos vendosni enë furre ose objekte të tjera drejtpërdrejt në fund të pajisjes.

  – Mos fusni letër alumini direkt në pjesën e poshtme të pajisjes.

  – mos hidhni ujë drejtpërdrejt në pajisjen e nxehtë.

  – mos lini enë të lagura dhe ushqim në pajisje pasi të keni mbaruar gatimin.

  – bëni kujdes kur hiqni ose vendosni aksesorët.
- Çngjyrimi i smaltit nuk ndikon në funksionimin e pajisjes. Ai nuk konsiderohet defekt në kuptimin e ligjit për garancinë.
- Përdorni një tigan të thellë për kek të njomë. Lëngjet e frutave shkaktojnë njolla që mund të jenë të përhershme.

2.3 Kujdesi dhe pastrimi

PARALAJMËRIM
Rrezik lëndimi, zjarri ose dëmtimi të pajisjes.

- Përpara se të kryeni mirëmbajtjen e pajisjes, çaktivizojeni atë dhe hiqeni nga priza.
- Sigurohuni që pajisja të jetë e ftohtë. Ka rrezik që panelet e xhamit të thyhen.
- Ndërrojini menjëherë panelet prej xhami të derës kur janë të dëmtuara. Lidhuni me Servisin.
- Tregoni kujdes kur ta hiqni derën nga pajisja. Dera është e rëndë!
- Pastrojeni pajisjen rregullisht për të parandaluar dëmtimin e materialit të sipërfaqes.
- Yndyra ose ushqimi i mbetur brenda pajisjes mund të shkaktojë zjarr.
- Pastrojeni pajisjen me një leckë të butë të lagësht. Përdorni vetëm detergjente neutrale. Mos përdorni produkte gërryese, materiale pastruese të ashpra, tretës ose objekte metalike.
- Nëse përdorni spërkatës për furrën, ndiqni udhëzimet e sigurisë në paketim.
- Mos e pastroni smaltin katalitik (nëse ka) me asnjë lloj detergjenti.

2.4 Drita e brendshme

- Lloji i llambës ose llambës halogjene të përdorur për këtë pajisje, është vetëm për pajisje elektroshtëpiake. Mos e përdorni atë për ndriçim banese.

PARALAJMËRIM
Rrezik nga goditja elektrike.

- Përpara ndërrimit të llambës, shkëputeni pajisjen nga korrenti.
- Përdorni vetëm llamba me të njëjtat specifikime.

2.5 Eliminimi i pajisjes

PARALAJMËRIM
Rrezik lëndimi ose mbytjeje.

- Shkëputeni pajisjen nga rrjeti i furnizimit elektrik.
- Prisni kabllon e lidhjes me rrjetin dhe hidheni.
- Hiqni kapësen e derës për të parandaluar bllokimin brenda pajisjes të fëmijëve dhe të kafshëve shtëpiake.

3. PËRSHKRIM I PRODUKTIT



1 Çelësi i funksioneve të furrës
2 Treguesi i energjisë
3 Programuesi elektronik
4 Çelësi i temperaturës
5 Treguesi i temperaturës
6 Skarë
7 Llamba e furrës
8 Ventilatori
9 Mbështetëset e rafteve, të çmontueshme
10 Pllaketa regjistruese
11 Pozicionet e raftit

3.1 Aksesorët e furrës

- **Rafti me rrjetë**
  Për enët e gatimit, tavat e kekëve dhe të pjekjes.
- **Tavë për pjekje**
  Për ëmbëlsira dhe biskota.
- **Tava e skarës/pjekjes**
  Për të pjekur ose si tavë për të mbledhur yndyrën.

4. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË

PARALAJMËRIM
Referojuni kapitujve të sigurisë.

4.1 Pastrimi paraprak

- Hiqni të gjithë aksesorët dhe mbështetëset e rafteve që mund të hiqen (nëse ka).
- Pastroni pajisjen përpara përdorimit të parë.

Referojuni kapitullit "Kujdesi dhe pastrimi".

4.2 Vendosja e orës

Përpara se të përdorni furrën, duhet që të caktoni orën.

Kur e lidhni pajisjen me rrjetin elektrik ose pas një ndërprerjeje të rrymës, treguesi i funksionit të orës ditore pulson.
Shtypni butonin **+** ose **-** për të vendosur orën e saktë.



Pas rreth pesë sekondash, pulsimi do të ndalet dhe në ekran do të afishohet ora që keni regjistruar.

Për të ndryshuar orën shtypni vazhdimisht derisa të pulsojë treguesi i orës ditore. Nuk duhet të vendosni funksionin Kohëzgjatja I→I ose Përfundimi →I njëkohësisht.

4.3 Parangrohja

Ngrohni paraprakisht pajisjen bosh për të djegur yndyrën e mbetur.

1. Vendosni funksionin dhe temperaturën maksimale.
2. Lëreni pajisjen të punoj për rreth një orë.
3. Vendosni funksionin dhe temperaturën maksimale.
4. Lëreni pajisjen të punoj për rreth dhjetë minuta.
5. Vendosni funksionin dhe temperaturën maksimale.
6. Lëreni pajisjen të punoj për rreth dhjetë minuta.

Aksesorët mund të nxehen më shumë sesa zakonisht. Pajisja mund të nxjerrë erë të keqe dhe tym. Kjo është normale. Sigurohuni që të ketë ajrosje të mjaftueshme.

5. PËRDORIMI I PËRDITSHËM

PARALAJMËRIM
Referojuni kapitujve të sigurisë.

Për të përdorur pajisjen, shtypni çelësin. Çelësi del jashtë.

5.1 Aktivizimi dhe çaktivizimi i pajisjes

1. Çojeni çelësin e funksioneve të furrës te funksioni i dëshiruar.

   Kur pajisja është në funksionim, treguesi i fuqisë qëndron i ndezur.
2. Rrotullojeni çelësin e temperaturës te temperatura e përzgjedhur.

   Treguesi i temperaturës ndizet kur temperatura e pajisjes rritet.
3. Për ta çaktivizuar pajisjen, rrotullojeni çelësin e kontrollit të funksioneve të furrës dhe çelësin e temperaturës në pozicionin e fikjes.

5.2 Funksionet e furrës

Funksioni i furrës		Përdorimi
0	Pozicioni fikur	Pajisja është e fikur.
	Të lehta	Për të aktivizuar llambën e furrës pa një funksion gatimi.

Funksioni i furrës		Përdorimi
	Gatim tradicional	Për të pjekur dhe skuqur në një nivel të furrës. Elementët e nxehjes poshtë dhe lart vihen në punë njëkohësisht.
	Nxehja nga sipër	Për të përfunduar ushqimet e gatuara. Funksionon vetëm elementi i sipërm i ngrohjes.
	Nxehtësia e poshtme	Për pjekjen e kekëve me bazë krokante ose të thekur. Funksionon vetëm elementi i poshtëm i ngrohjes.
	Pjekja në skarë	Për të pjekur në skarë ushqime të sheshta në sasi të vogla në qendër të raftit. Për të thekur.
	Skarë e shpejtë	Për të pjekur në skarë ushqime të sheshta në sasi të mëdha. Për të thekur. Funksionon elementi i plotë i skarës.
	Skarë turbo	Për gatimin e copave të mëdha të mishit. Elementi i skarës dhe ventilatori i furrës punojnë njëri pas tjetrit, duke qarkulluar ajër të nxehtë rreth e qark ushqimit.
	Ventilator i plotë / Shkrirje	Për pjekjen dhe gatimin e ushqimeve me të njëjtën temperaturë gatimi, duke përdorur më shumë se një nivel të furrës, pa përzierjen e erërave. / Për të shkrirë ushqimet e ngrira. Çelësi i temperaturës duhet të jetë në pozicionin fikur
	Cilësimi për pica	Për të bërë pica, quiche ose kek. Skara dhe elementi i poshtëm japin nxehtësi të drejtpërdrejtë dhe ventilatori qarkullon ajër të nxehtë për të gatuar shtresat e picave ose mbushjet e kekëve.

6. FUNKSIONET E ORËS

6.1 Programuesi elektronik



1 Treguesit e funksioneve
2 Afishimi i kohës
3 Treguesi i funksionit
4 Butoni +
5 Butoni i përzgjedhjes
6 Butoni -

Funksioni i orës		Përdorimi
	Ora e ditës	Për të vendosur, ndryshuar ose kontrolluar orën ditore.

Funksioni i orës		Përdorimi
🔔	Kujtuesi i minutave	Për të vendosur një numërim mbrapsht. Ky funksion nuk ndikon në funksionimin e furrës.
|→|	Kohëzgjatja	Për të vendosur sa kohë duhet të jetë në punë pajisja.
→|	Përfundimi	Për të vendosur kohën kur duhet të çaktivizohet pajisja.

Ju mund të përdorni Kohëzgjatja \|→\| dhe Përfundimi →\| në të njëjtën kohë, kur pajisja duhet të aktivizohet dhe më pas të çaktivizohet. Vendosni në fillim Kohëzgjatjen \|→\| , dhe pastaj Përfundimin →\| .

6.2 Cilësimi i funksioneve të orës

1. Për Kohëzgjatjen \|→\| dhe Përfundimin →\| , vendosni një funksion të furrës dhe temperaturën. Kjo nuk është e nevojshme për Kujtuesin e minutave 🔔 .
2. Shtypni butonin e përzgjedhjes vazhdimisht, derisa treguesi i funksionit të dëshiruar të orës të fillojë pulsimin.



3. Shtypni **+** ose **-** për të vendosur kohën për funksionin e nevojshëm të orës.

   Ekrani shfaq treguesin për funksionin e orës që vendosët. Kur përfundon koha e vendosur, treguesi pulson dhe tingëllon një sinjal akustik për dy minuta.

Me funksionet Kohëzgjatja \|→\| dhe Përfundimi →\| pajisja çaktivizohet automatikisht.

4. Shtypni një buton për të ndërprerë sinjalin.
5. Rrotullojeni çelësin e kontrollit të funksioneve të furrës dhe çelësin e temperaturës në pozicionin e fikjes.

6.3 Anulimi i funksioneve të orës

1. Shtypni butonin e përzgjedhjes vazhdimisht, derisa treguesi i funksionit të dëshiruar të fillojë pulsimin.
2. Shtypni dhe mbani shtypur butonin **-**.

   Pas pak sekondash funksioni i orës fiket.

7. FUNKSIONET SHTESË

7.1 Ventilatori ftohës

Kur pajisja është në punë, ventilatori ftohës aktivizohet automatikisht për t'i mbajtur sipërfaqet e pajisjes të ftohta. Nëse çaktivizoni pajisjen, ventilatori i ftohjes mund të vazhdojë të punojë derisa të ftohet temperatura në pajisje.

7.2 Termostati i sigurisë

Përdorimi i pasaktë i pajisjes ose pjesët me defekt mund të shkaktojnë mbinxehje të rrezikshme. Për ta parandaluar këtë, furra ka një termostat sigurie që ndërpret furnizimin me energji. Furra ndizet aktivizohet përsëri automatikisht kur bie temperatura.

8. UDHËZIME DHE KËSHILLA TË NEVOJSHME

- Pajisja ka pesë nivele raftesh. Numërojini nivelet e pajisjes duke filluar nga poshtë.
- Pajisja ka një sistem të veçantë që qarkullon ajrin dhe riciklon vazhdimisht avullin. Me këtë sistem bëhet i mundur gatimi në një ambient me avull dhe i mban gatesat të buta brenda dhe të pjekura mirë nga jashtë. Ai ul kohën e gatimit dhe konsumin e energjisë në minimum.
- Në pajisje ose në panelet e dyerve prej xhami mund të kondensohet lagështi. Kjo është normale. Qëndroni gjithmonë pak larg pajisjes kur hapni derën e pajisjes ndërsa është në punë. Për të ulur kondensimin, përdoreni pajisjen bosh për 10 minuta para gatimit.
- Fshini lagështinë e formuar pas çdo përdorimi të pajisjes.
- Mos vendosni objekte drejtpërdrejt mbi bazën e pajisjes dhe mos i mbuloni pjesët e pajisjes me letër alumini gjatë gatimit. Kjo mund të ndryshojë rezultatet e pjekjes dhe mund të shkaktojë dëmtimin e smaltit të furrës.

8.1 Pjekja e kekëve

- Mos e hapni derën e furrës para se të ketë kaluar 3/4 e kohës së pjekjes.
- Nëse përdorni dy tava pjekjeje njëkohësisht, mbajeni një nivel bosh mes tyre.

8.2 Gatimi i mishit dhe peshkut

- Përdorni një tavë të thellë për ushqimet me shumë yndyrë, për të ruajtur furrën nga njollat që mund të mos ikin më.
- Lëreni mishin afro 15 minuta përpara se ta shponi, në mënyrë që lëngu të mos derdhet jashtë.
- Për të parandaluar tymin e tepërt në furrë gjatë pjekjes, hidhni pak ujë në tavën e thellë. Për të parandaluar kondensimin e tymit, shtoni ujë sa herë që të thahet.

8.3 Kohët e gatimit

Kohët e gatimit varen nga lloji, shpeshtësia dhe vëllimi i ushqimit. Fillimisht, kontrolloni funksionimin e pajisjes kur gatuani. Gjeni përzgjedhjet më të mira (përzgjedhjet e nxehtësisë, kohët e gatimit, etj.) për gatesat tuaja, recetat dhe sasitë përkatëse kur përdorni pajisjen.

8.4 Tabela e pjekjes dhe e skuqjes

KEK

LLOJI I GATIMIT	Gatim tradicional		Gatim me ventilator të plotë		Koha e gatimit [në minuta]	Shënime
	Pozicioni i raftit	Temp [°C]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]		
Recetat me qull të rrahur	2	170	3 (2 dhe 4)	160	45 - 60	Në një formë keku
Brumë i shkrifët për ëmbëlsirë	2	170	3 (2 dhe 4)	160	20 - 30	Në një formë keku
Kek me gjalpë qumështi e krem bulmeti	1	170	2	165	60 - 80	Në një formë keku 26 cm

LLOJI I GATIMIT	Gatim tradicional		Gatim me ventilator të plotë		Koha e gatimit [në minuta]	Shënime
	Pozicioni i raftit	Temp [°C]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]		
Kek me mollë (Ëmbëlsirë me mollë)	2	170	2 (majtas dhe djathtas)	160	80 - 100	Në 2 forma keku prej 20 cm në një raft me rrjetë[1)]
Strudel	3	175	2	150	60 - 80	Në një tavë pjekjeje
Ëmbëlsirë me reçel	2	170	2 (majtas dhe djathtas)	165	30 - 40	Në një formë keku 26 cm
Pandispanjë	2	170	2	160	50 - 60	Në një formë keku 26 cm
Kek krishtlindjesh /Kek i pasur me fruta	2	160	2	150	90 - 120	Në një formë keku 20 cm[1)]
Kek me kumbulla	1	175	2	160	50 - 60	Në një tavë buke[1)]
Kekë të vegjël - në një nivel	3	170	3	140 - 150	20 - 30	Në një tavë pjekjeje
Kekë të vegjël - në dy nivele	-	-	2 dhe 4	140 - 150	25 - 35	Në një tavë pjekjeje
Kekë të vegjël - në tre nivele	-	-	1, 3 dhe 5	140 - 150	30 - 45	Në një tavë pjekjeje
Biskota / rripa brumi të shkrifët - në një nivel	3	140	3	140 - 150	30 - 35	Në një tavë pjekjeje
Biskota / rripa brumi të shkrifët - në dy nivele	-	-	2 dhe 4	140 - 150	35 - 40	Në një tavë pjekjeje
Biskota / rripa brumi të shkrifët - në tre nivele	-	-	1, 3 dhe 5	140 - 150	35 - 45	Në një tavë pjekjeje
Mafishe - në një nivel	3	120	3	120	80 - 100	Në një tavë pjekjeje

LLOJI I GATIMIT	Gatim tradicional		Gatim me ventilator të plotë		Koha e gatimit [në minuta]	Shënime
	Pozicioni i raftit	Temp [°C]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]		
Mafishe - në dy nivele	-	-	2 dhe 4	120	80 - 100	Në një tavë pjekjeje[1)]
Simite	3	190	3	190	12 - 20	Në një tavë pjekjeje[1)]
Ekler - në një nivel	3	190	3	170	25 - 35	Në një tavë pjekjeje
Ekler - në dy nivele	-	-	2 dhe 4	170	35 - 45	Në një tavë pjekjeje
Torta të sheshta	2	180	2	170	45 - 70	Në një formë keku 20 cm
Kek i pasur me fruta	1	160	2	150	110 - 120	Në një formë keku 24 cm
Kek "Viktoria"	1	170	2	160	50 - 60	Në një formë keku 20 cm

1) Ngroheni paraprakisht për 10 minuta.

BUKË DHE PICA

LLOJI I GATIMIT	Gatim tradicional		Gatim me ventilator të plotë		Koha e gatimit [në minuta]	Shënime
	Pozicioni i raftit	Temp [°C]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]		
Bukë e bardhë	1	190	1	190	60 - 70	1 - 2 copë, 500 g për çdo copë[1)]
Bukë thekre	1	190	1	180	30 - 45	Në një tavë buke
Simite	2	190	2 (2 dhe 4)	180	25 - 40	6 - 8 simite në një tavë të sheshtë pjekjeje[1)]
Pica	1	230 - 250	1	230 - 250	10 - 20	Në një tavë pjekjeje ose tavë të thellë pjekjeje[1)]
Gurabije	3	200	3	190	10 - 20	Në një tavë pjekjeje[1)]

1) Ngroheni paraprakisht për 10 minuta.

KREM I PJEKUR

LLOJI I GATIMIT	Gatim tradicional		Gatim me ventilator të plotë		Koha e gatimit [në minuta]	Shënime
	Pozicioni i raftit	Temp [°C]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]		
Bazë brumi	2	200	2	180	40 - 50	Në një formë
Pite me perime	2	200	2	175	45 - 60	Në një formë
Quiche	1	180	1	180	50 - 60	Në një formë 1)
Lazanja	2	180 - 190	2	180 - 190	25 - 40	Në një formë 1)
Kaneloni	2	180 - 190	2	180 - 190	25 - 40	Në një formë 1)

1) Ngroheni paraprakisht për 10 minuta.

MISH

LLOJI I GATIMIT	Gatim tradicional		Gatim me ventilator të plotë		Koha e gatimit [në minuta]	Shënime
	Pozicioni i raftit	Temp [°C]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]		
Mish lope	2	200	2	190	50 - 70	Në një raft me rrjetë
Mish derri	2	180	2	180	90 - 120	Në një raft me rrjetë
Viç	2	190	2	175	90 - 120	Në një raft me rrjetë
Rosto viçi angleze, e pjekur pak	2	210	2	200	50 - 60	Në një raft me rrjetë
Rosto viçi angleze, e pjekur mesatarisht	2	210	2	200	60 - 70	Në një raft me rrjetë
Rosto viçi angleze, e pjekur mirë	2	210	2	200	70 - 75	Në një raft me rrjetë
Shpatull derri	2	180	2	170	120 - 150	Me lëkurë
Kërci derri	2	180	2	160	100 - 120	2 copë

LLOJI I GATIMIT	Gatim tradicional		Gatim me ventilator të plotë		Koha e gatimit [në minuta]	Shënime
	Pozicioni i raftit	Temp [°C]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]		
Mish qengji	2	190	2	175	110 - 130	Kofshë
Pulë	2	220	2	200	70 - 85	I paprerë
Gjel deti	2	180	2	160	210 - 240	I paprerë
Rosë	2	175	2	220	120 - 150	I paprerë
Patë	2	175	1	160	150 - 200	I paprerë
Lepur	2	190	2	175	60 - 80	I prerë në copa
Lepur i egër	2	190	2	175	150 - 200	I prerë në copa
Fazan	2	190	2	175	90 - 120	I paprerë

PESHK

LLOJI I GATIMIT	Gatim tradicional		Gatim me ventilator të plotë		Koha e gatimit [në minuta]	Shënime
	Pozicioni i raftit	Temp [°C]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]		
Troftë / Krap deti	2	190	2	175	40 - 55	3 - 4 peshq
Peshk ton/ Salmon	2	190	2	175	35 - 60	4 - 6 fileto

8.5 Pjekja në skarë

Nxehni paraprakisht furrën bosh për 10 minuta, para gatimit.

	Sasia		Pjekja në skarë		Koha e gatimit [në minuta]	
LLOJI I GATIMIT	Copë	[g]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]	Njëra anë	Ana tjetër
Biftek fileto	4	800	4	maks.	12-15	12-14
Biftek	4	600	4	maks.	10-12	6-8
Salsiçe	8	-	4	maks.	12-15	10-12
Kotëleta derri	4	600	4	maks.	12-16	12-14
Pulë (e ndarë në 2 pjesë)	2	1000	4	maks.	30-35	25-30

	Sasia		Pjekja në skarë		Koha e gatimit [në minuta]	
LLOJI I GATIMIT	**Copë**	**[g]**	**Pozicioni i raftit**	**Temp [°C]**	**Njëra anë**	**Ana tjetër**
Qebapë	4	-	4	maks.	10-15	10-12
Gjoks pule	4	400	4	maks.	12-15	12-14
Hamburger	6	600	4	maks.	20-30	-
Filetë peshku	4	400	4	maks.	12-14	10-12
Sanduiçë të thekur	4-6	-	4	maks.	5-7	-
Bukë e thekur	4-6	-	4	maks.	2-4	2-3

8.6 Skarë turbo

Mish lope

LLOJI I GATIMIT	Sasia	Pozicioni i raftit	Temperatura [°C]	Koha [minuta]
Bërxolla gjedhi ose fileto, e gatuar pak	për cm trashësi	1	190 - 200 **1)**	5 - 6
Bërxollë gjedhi ose fileto, e gatuar mesatarisht	për cm trashësi	1	180 - 190 **1)**	6 - 8
Bërxollë gjedhi ose fileto, e gatuar mirë	për cm trashësi	1	170 - 180 **1)**	8 - 10

1) Nxehni furrën paraprakisht.

Mish derri

LLOJI I GATIMIT	Sasia	Pozicioni i raftit	Temperatura [°C]	Koha [minuta]
Shpatull, qafë, kofshë	1 - 1,5 kg	1	160 - 180	90 - 120
Bërxolla, brinjë	1 - 1,5 kg	1	170 - 180	60 - 90
Qofte	750 g - 1 kg	1	160 - 170	50 - 60
Nyje derri (gjysmë e gatuar)	750 g - 1 kg	1	150 - 170	90 - 120

Viç

LLOJI I GATIMIT	Sasia	Pozicioni i raftit	Temperatura [°C]	Koha [minuta]
Mish viçi i pjekur	1 kg	1	160 - 180	90 - 120

LLOJI I GATIMIT	Sasia	Pozicioni i raftit	Temperatura [°C]	Koha [minuta]
Nyjë viçi	1,5 - 2 kg	1	160 - 180	120 - 150

Mish qengji

LLOJI I GATIMIT	Sasia	Pozicioni i raftit	Temperatura [°C]	Koha [minuta]
Kofshë qengji, rosto qengji	1 - 1,5 kg	1	150 - 170	100 - 120
Shpinë qengji	1 - 1,5 kg	1	160 - 180	40 - 60

Shpezë

LLOJI I GATIMIT	Sasia	Pozicioni i raftit	Temperatura [°C]	Koha [minuta]
Porcione shpezësh	200 - 250 g secila	1	200 - 220	30 - 50
Gjysma pule	400 - 500 g secila	1	190 - 210	35 - 50
Pulë, pulastren	1 - 1,5 kg	1	190 - 210	50 - 70
Rosë	1,5 - 2 kg	1	180 - 200	80 - 100
Patë	3,5 - 5 kg	1	160 - 180	120 - 180
Gjel deti	2,5 - 3,5 kg	1	160 - 180	120 - 150
Gjel deti	4 - 6 kg	1	140 - 160	150 - 240

Peshk (i gatuar me avull)

LLOJI I GATIMIT	Sasia	Pozicioni i raftit	Temperatura [°C]	Koha [minuta]
Peshk i plotë	1 - 1,5 kg	1	210 - 220	40 - 60

8.7 Shkrirja

LLOJI I GATIMIT	[g]	Koha e shkrirjes [në minuta]	Koha e shkrirjes së mëtejshme [në minuta]	Shënime
Pulë	1000	100 - 140	20 - 30	Vendoseni pulën mbi një pjatë të sheshtë të kthyer në një pjatancë të madhe. Kthejeni pasi të ketë kaluar gjysma e kohës.
Mish	1000	100 - 140	20 - 30	Kthejeni pasi të ketë kaluar gjysma e kohës.

LLOJI I GATIMIT	[g]	Koha e shkrirjes [në minuta]	Koha e shkrirjes së mëtejshme [në minuta]	Shënime
Mish	500	90 - 120	20 - 30	Kthejeni pasi të ketë kaluar gjysma e kohës.
Troftë	150	25 - 35	10 - 15	-
Luleshtrydhe	300	30 - 40	10 - 20	-
Gjalpë	250	30 - 40	10 - 15	-
Ajkë	2 x 200	80 - 100	10 - 15	Kajmaku mund të rrihet edhe kur në disa vende është ende pak i ngrirë.
Tortë	1400	60	60	-

8.8 Konservimi - Nxehtësia e poshtme

Fruta të buta

KONSERVIMI	Temperatura [°C]	Zierja deri në fillimin e pikimit [minuta]	Koha e gatimit të mëtejshëm në 100 °C [minuta]
Luleshtrydhe, boronica, mjedra, kullumbri të pjekura	160 – 170	35 – 45	–

Fruta me bërthamë

KONSERVIMI	Temperatura [°C]	Zierja deri në fillimin e pikimit [minuta]	Koha e gatimit të mëtejshëm në 100 °C [minuta]
Dardha, ftonj, kumbulla	160 – 170	35 – 45	10 – 15

Zarzavate

KONSERVIMI	Temperatura [°C]	Zierja deri në fillimin e pikimit [minuta]	Koha e gatimit të mëtejshëm në 100 °C [minuta]
Karota [1)]	160 – 170	50 – 60	5 – 10
Kastravecë	160 – 170	50 – 60	–
Turshi të përziera	160 – 170	50 – 60	5 – 10
Lakër rrepe, bizele, shpargull	160 – 170	50 – 60	15 – 20

1) Pasi çaktivizoni pajisjen, lëreni konservën në furrë.

8.9 Tharja - Ventilator i plotë

Mbulojini raftet e furrës me letër gatimi.

PERIME

LLOJI I GATIMIT	Pozicioni i raftit		Temperatura [°C]	Koha [orë]
	1 nivel	2 nivele		
Fasule	3	1/4	60 - 70	6 - 8
Speca	3	1/4	60 - 70	5 - 6
Perime për supë	3	1/4	60 - 70	5 - 6
Kërpudha	3	1/4	50 - 60	6 - 8
Barishte erëzash	3	1/4	40 - 50	2 - 3

FRUTA

LLOJI I GATIMIT	Pozicioni i raftit		Temperatura [°C]	Koha [orë]
	1 nivel	2 nivele		
Kumbulla	3	1/4	60 - 70	8 - 10
Kajsi	3	1/4	60 - 70	8 - 10
Feta molle	3	1/4	60 - 70	6 - 8
Dardhë	3	1/4	60 - 70	6 - 9

9. KUJDESI DHE PASTRIMI

PARALAJMËRIM
Referojuni kapitujve të sigurisë.

- Pastroni pjesën e përparme të pajisjes me një copë të butë me ujë të ngrohtë dhe një agjent pastrues.
- Për të pastruar sipërfaqet metalike përdorni agjent të zakonshëm pastrimi.
- Pastrojeni furrën nga brenda pas çdo përdorimi. Më pas mund të pastroni ndotjet më lehtë e të mos i lejoni të digjen.
- Ndotjet e forta pastrojini me një pastrues të posaçëm për furrat.
- Pastrojini të gjithë aksesorët e furrës pas çdo përdorimi dhe lërini të thahen. Përdorni një leckë të butë me ujë të ngrohtë dhe agjent pastrues.
- Nëse keni aksesorë që nuk ngjisin, mos i pastroni duke përdorur lëndë agresive, sende me cepa të mprehta ose në enëlarëse. Mund të dëmtohet shtresa që nuk ngjit.

Pajisjet prej inoksi ose alumini:
Pastrojeni derën e furrës vetëm me sfungjer të lagur. Thajeni me leckë të butë.
Mos përdorni tel krues, acide ose materiale gërryese, pasi ato mund të dëmtojnë sipërfaqen e furrës.
Pastroni panelin e kontrollit të furrës duke marrë të njëjtat masa paraprake.

9.1 Pastrimi i guarnicionit të derës

- Guarnicionin e derës kontrollojeni rregullisht. Guarnicioni i derës ndodhet rreth kornizën së hapësirës së furrës. Mos e përdorni pajisjen nëse

guarnicioni i derës është i dëmtuar. Lidhuni me Qendrën e Shërbimit.

- Për të pastruar guarnicionin e derës shikoni informacionin e përgjithshëm mbi pastrimin.

9.2 Mbështetëset e rafteve

Ju mund të hiqni mbështetëset e rafteve për të pastruar muret anësore.

Heqja e mbështetëseve të rafteve



1. Tërhiqni pjesën ballore të mbështetëses nga muri anësor.



2. Tërhiqni pjesën e pasme të mbështetëses së rafteve jashtë murit anësor dhe hiqeni.

Montimi i mbështetëseve të rafteve

Montoni mbështetëset e rafteve në rendin e kundërt.

Skajet e rrumbullakuara të mbështetëseve të rafteve duhen vendosur nga përpara.

9.3 Tavani i furrës

Ju mund ta hiqni skarën për të pastruar më lehtë tavanin e furrës.

PARALAJMËRIM
Çaktivizojeni pajisjen para se të hiqni skarën. Sigurohuni që pajisja të jetë e ftohtë. Ka rrezik djegieje.

1. Hiqni vidën që mban skarën. Herën e parë, përdorni një kaçavidë.



2. Me kujdes tërhiqeni poshtë skarën.
3. Pastrojeni tavanin e furrës me një copë të butë e me ujë e pastrues dhe lëreni të thahet.
4. Montoni skarën sipas rendit të kundërt.

PARALAJMËRIM
Sigurohuni që skara të jetë montuar saktë dhe që nuk bie poshtë.

9.4 Llamba e furrës

PARALAJMËRIM
Bëni kujdes kur ndërroni llambën e furrës. Ka rrezik goditjeje elektrike.

Përpara se të zëvendësoni llambën e furrës:

- Çaktivizoni furrën.
- Hiqni siguresat në kutinë e siguresave ose çaktivizoni çelësin stakues.

Për të mos lejuar dëmtimin e llambës së furrës dhe kapakut prej xhami, vendosni një leckë në fund të furrës.
Llambën halogjene kapeni gjithmonë me një pecetë për të evituar djegien e mbetjeve të yndyrshme mbi llambë.

1. Rrotullojeni kapakun prej xhami në drejtim të kundërt të akrepave të orës për ta çmontuar.
2. Pastroni mbulesën prej xhami.
3. Zëvendësojeni llambën e furrës me një llambë furre që i reziston temperaturës 300°C.
   Përdorni të njëjtin lloj llambe furre.
4. Montoni mbulesën prej xhami.

9.5 Pastrimi i derës së furrës

Dera e furrës është e përbërë nga dy panele xhami. Mund të hiqni derën e furrës dhe panelin e brendshëm prej xhami për ta pastruar.

Dera e furrës mund të mbyllet nëse përpiqeni të hiqni panelet e brendshme prej xhami, përpara se të hiqni derën e furrës.

Çmontimi i derës së furrës dhe panelit prej xhami



1. Hapeni derën plotësisht dhe mbani dy menteshat e derës.



2. Ngrini dhe rrotulloni levat mbi dy menteshat.



3. Mbyllni derën e furrës në pozicionin e parë të hapjes (përgjysmë). Pastaj tërhiqeni atë përpara dhe hiqeni derën nga foleja.



4. Vendoseni derën mbi një cohë të butë në një sipërfaqe të qëndrueshme.



5. Lironi sistemin bllokues për të hequr panelet e brendshme prej xhami.



6. Rrotullojini dy mbërthyeset 90° dhe nxirrini ato nga foletë e tyre.



7. Ngrini me kujdes (hapi 1) dhe hiqni (hapi 2) panelin prej xhami.
8. Pastroni panelin e xhamit me ujë dhe sapun. Fshijini panelin prej xhami me kujdes.

Montimi i derës dhe panelit të xhamit



Kur të ketë përfunduar procedura e pastrimit, montoni panelin prej xhami dhe derën e furrës. Kryejini hapat e mësipërm sipas rendit të kundërt.
Zona e afishimit duhet të vendoset përballë pjesës së brendshme të derës. Sigurohuni që pas instalimit sipërfaqja e kornizës së panelit prej xhami në ana e printuar të mos jetë e ashpër kur e prekni. Sigurohuni që të instaloni saktë në mbajtëse panelin e brendshëm prej xhami. Referojuni figurës.

10. SI TË VEPROJMË NËSE…

PARALAJMËRIM
Referojuni kapitujve të sigurisë.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Furra nuk nxehet.	Pajisja është çaktivizuar.	Aktivizoni pajisjen.
Furra nuk nxehet.	Nuk është vendosur ora.	Vendosni orën.
Furra nuk nxehet.	Nuk janë bërë cilësimet e nevojshme.	Sigurohuni që të gjitha cilësimet të jenë të sakta.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Furra nuk nxehet.	Ka rënë siguresa në kutinë e siguresave.	Kontrolloni siguresën. Nëse siguresa bie më shumë se një herë, kontaktoni një elektricist të kualifikuar.
Llamba e furrës nuk funksionon.	Llamba e furrës është me defekt.	Zëvendësoni llambën e furrës.
Në ekran shfaqet **12.00**.	Ka pasur ndërprerje të energjisë.	Vendosni orën.
Mbi ushqim dhe brenda furrës grumbullohet avull dhe bulëza të kondensuara.	I keni lënë ushqimet në furrë për shumë kohë.	Mos i mbani gatimet në furrë për më shumë se 15-20 minuta pas përfundimit të gatimit.

Nëse nuk e gjeni dot vetë një zgjidhje, lidhuni me shitësin tuaj ose qendrën e shërbimit.
Të dhënat e nevojshme për qendrën e shërbimit ndodhen në etiketën e specifikimeve. Pllaka e specifikimeve gjendet në kornizën ballore të hapësirës së pajisjes.

Rekomandojmë që ju t'i shkruani të dhënat këtu:

Modeli (MOD.) .....

Numri i produktit (PNC) .....

Numri serial (S.N.) .....

11. TË DHËNA TEKNIKE

Tensioni	230 V
Frekuenca	50 Hz

12. INSTALIMI

PARALAJMËRIM
Referojuni kapitujve të sigurisë.

12.1 Montimi









12.2 Instalimi elektrik

PARALAJMËRIM
Instalimin elektrik duhet ta kryejë vetëm një person i kualifikuar.

Prodhuesi nuk mban përgjegjësi nëse nuk i ndiqni masat e sigurisë të përshkruara në kapitullin "Të dhëna për sigurinë".

Kjo pajisje ofrohet me spinë dhe kabllo elektrike.

12.3 Kablloja

Llojet e kabllove të përshtatshme për instalim ose zëvendësim: H07 RN-F, H05 RN-F, H05 RRF, H05 VV-F, H05 V2V2-F (T90), H05 BB-F.
Për pjesën e kabllon shikoni fuqinë totale (te etiketa e specifikimeve) dhe te tabela:

Fuqia totale	Pjesa e kabllos
maksimumi 1380 W	3 x 0,75 mm^2
maksimumi 2300 W	3 x 1 mm^2
maksimumi 3680 W	3 x 1,5 mm^2

Teli i tokëzimit (jeshil/të verdhë) duhet të jetë 2 cm më i gjatë se telat e fazës dhe të nulit (blu dhe kafe).

13. PROBLEME QË LIDHEN ME MJEDISIN

Ricikloni materialet me simbolin .

Vendoseni ambalazhin te kontenierët e riciklimit nëse ka.
Ndihmoni në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve dhe në riciklimin e mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Mos hidhni pajisjet e shënuara me simbolin e mbeturinës shtëpiake.

Ktheni produktin në pikën lokale të riciklimit ose kontaktoni me zyrën komunale.

СОДЕРЖАНИЕ

1. СВЕДЕНИЯ ПО ТЕХНИКЕ БЕЗОПАСНОСТИ 27
2. УКАЗАНИЯ ПО БЕЗОПАСНОСТИ 28
3. ОПИСАНИЕ ИЗДЕЛИЯ 30
4. ПЕРЕД ПЕРВЫМ ИСПОЛЬЗОВАНИЕМ 31
5. ЕЖЕДНЕВНОЕ ИСПОЛЬЗОВАНИЕ 31
6. ФУНКЦИИ ЧАСОВ 33
7. ДОПОЛНИТЕЛЬНЫЕ ФУНКЦИИ 34
8. ПОЛЕЗНЫЕ СОВЕТЫ 34
9. УХОД И ОЧИСТКА 43
10. ЧТО ДЕЛАТЬ, ЕСЛИ 47
11. ТЕХНИЧЕСКИЕ ДАННЫЕ 48
12. УСТАНОВКА 48

МЫ ДУМАЕМ О ВАС

Благодарим Вас за приобретение прибора Electrolux. Вы выбрали изделие, за которым стоят десятилетия профессионального опыта и инноваций. Уникальное и стильное, оно создавалось с заботой о Вас. Поэтому когда бы Вы ни воспользовались им, Вы можете быть уверены: результаты всегда будут превосходными.

Добро пожаловать в Electrolux!

На нашем веб-сайте Вы сможете:

Найти рекомендации по использованию изделий, руководства по эксплуатации, мастер устранения неисправностей, информацию о техническом обслуживании:
www.electrolux.com

Зарегистрировать свое изделия для улучшения обслуживания:
www.electrolux.com/productregistration

Приобрести дополнительные принадлежности, расходные материалы и фирменные запасные части для своего прибора:
www.electrolux.com/shop

ПОДДЕРЖКА ПОТРЕБИТЕЛЕЙ И СЕРВИСНОЕ ОБСЛУЖИВАНИЕ

Мы рекомендуем использовать оригинальные запчасти.
При обращении в сервис-центр следует иметь под рукой следующую информацию.
Данная информация находится на табличке с техническими данными. Модель, код изделия (PNC), серийный номер.

Внимание / Важные сведения по технике безопасности.

Общая информация и рекомендации

Информация по защите окружающей среды

Право на изменения сохраняется.

1. СВЕДЕНИЯ ПО ТЕХНИКЕ БЕЗОПАСНОСТИ

Перед установкой и эксплуатацией прибора внимательно ознакомьтесь с приложенным руководством. Производитель не несет ответственность за травмы и повреждения, полученные/вызванные неправильной установкой и эксплуатацией. Позаботьтесь о том, чтобы данное руководство было у Вас под рукой на протяжении всего срока службы прибора.

1.1 Безопасность детей и лиц с ограниченными возможностями

⚠ **ВНИМАНИЕ!**
Существует риск удушья, получения травм или стойких нарушений нетрудоспособности.

- Данный прибор может эксплуатироваться детьми старше 8 лет и лицами с ограниченными физическими, сенсорными или умственными способностями или с недостаточным опытом или знаниями только при условии нахождения под присмотром лица, отвечающего за их безопасность.
- Не позволяйте детям играть с прибором.
- Храните все упаковочные материалы вне досягаемости детей.
- Не подпускайте детей и домашних животных к прибору, когда он работает или остывает. Доступные для контакта части прибора сохраняют высокую температуру.
- Если прибор оснащен функцией «Защита от детей», рекомендуется включить эту функцию.
- Очистка и доступное пользователю техническое обслуживание не должно производиться детьми без присмотра.

1.2 Общие правила техники безопасности

